**”Hib Petrol ” Sh.P.K. Ferizaj**

# RAPORT
# I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

**Për Stacionin e Karburanteve, Prizren (3)**




**Korrik, 2024**

## ”Hib Petrol” Sh.P.K. Ferizaj

HIB PETROL

# RAPORT
# I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

## Për Stacionin e Karburanteve, Prizren (3)

**Hartues i VNM-së:**

**Dr.sc. Raif  Bytyçi, inxh. i mjedisit, person fizik i licencuar**

________________________________________

**“Eko inxhiniering”sh.p.k.**
**Prishtinë**

**Aplikon për Pëlqim Mjedisor:**
**”Hib Petrol ”sh.p.k.**

**Korrik, 2024**

## PËMBAJTJA

1. HYRJE........ 5
2. BAZA LIGJORE PËR HARTIMIN E RAPORTIT........ 6
2.1 Rregullativa ligjore........ 6
2.2. Metodologjia e punës........ 8
3. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT........ 9
3.1. Potencialet ekzistuese ........ 9
3.2. Pozita gjeografike e lokacionit........ 10
3.3. Popullsia dhe vendbanimet ........ 14
3.4. Lidhjet e komunikacionit ........ 15
3.5. Kushtet klimatike ........ 15
3.6. Erërat ........ 16
3.7. Hidrologjia ........ 16
3.8. Natyra dhe biodiversiteti........ 16
3.9. Bimësia dhe vegjetacioni ........ 17
3.10. Fauna ........ 17
3.11. Peizazhi ........ 17
3.12. Ajri ........ 17
3.13. Uji ........ 18
3.14. Aspektet kulturore historike ........ 18
4. PËRSHKRIMI I KOMPLEKSIT TË STACIONIT TE KARBURANTEVE ........ 20
4.1. Platoja e kompleksit ........ 22
4.2. Rezervarët e lëndëve djegëse të lëngëta - naftë dhe benzinë........ 22
4.3. Karakteristikat e procesit ne stacionin e karburanteve ........ 24
4.4. Komponentët hyrëse në procesin teknologjik ........ 25
4.5. Komponentët dalëse në procesin teknologjik ........ 25
4.8. Alternativat e projektit........ 25
5. VLERËSIMI I NDIKIMIT NË MJEDIS ........ 26
5.1 Ndotja e tokës ........ 26
5.2. Ndotja e ujit ........ 27

5.3. Ndotja e ajri ........................................ 27
5.4. Zhurma ........................................ 28
5.5. Ndikimet në florë dhe faunë ........................................ 28
5.**6**.Rreziqet e mundshme ne mjedis - shëndet nga fatkeqësitë ose katarstrofat ......... 28
5.**7.** Ndikimet e mundshme në trashëgiminë kulturore ........................................ 29
6. VËLERSIMI I RREZIKIMIT TË MJEDISIT NGA AKSIDENTET ........................................ 29
7.1. Masat mbrojtëse të ujërave ........................................ 31
7.2. Masat mbrojtëse në rezervar ........................................ 33
7.3. Masat mbrojtëse në sistemin shpërndarës ........................................ 33
7.4. Veprime tjera për evitimin e rrezikut ........................................ 33
8.0. MASAT PËR REHABILITIMIN E MJEDISIT ........................................ 34
9. PËRMBLEDHJA JO TEKNIKE E INFORMATIVE ........................................ 35
9.1. Përshkrimi i shkurt i procesit ........................................ 35
9.2. Ndikimet ne mjedis ........................................ 36
9.3. Masat mjedisore ........................................ 37
10. Përfundime ........................................ 38

**Shtojca:**

Kostoja e Investimit ........................................ 39
Dokumentacioni ........................................ 40

# 1. HYRJE

Për hartimin e Raportit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve ”Hib Petrol” sh.p.k. ne vendin e quajtur B. Kidrica, rruga Lekë Matrënga - Prizren, nevojitet të bëhet analizë e ndikimeve të mundshme në mjedis.

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis paraqet një dokument të rëndësishëm dhe të nevojshëm për marrjen e pëlqimit mjedisor, dhe pastaj për marrjen e lejes mjedisore dhe operimin e stacionit të karburanteve.

Përmes këtij raporti të Vlerësimit të Ndikimit ne Mjedis do të përkufizohen të gjitha ndikimet relevante që mundë të paraqiten në relacionin stacioni i karburanteve dhe mjedisi jetësor duke marrë parasysh mjedisin e gjerë.

Hartimi i raportit për vlerësimin e ndikimit në mjedis bëhet me qëllim që në mënyrë transparente të paraqitet ndikimi në mjedis i stacionit të karburanteve me objektet përcjellëse me të gjitha veprimtarit punuese (shërbim, transport, deponim, trajtimi i materieve të rrezikshme etj), në mënyrë që të mundësohet ruajtja e mjedisit.

Ky vlerësim i ndikimit në mjedis për stacionin e karburanteve ”Hib Petrol”sh.p.k. ne lokacionin B. Kidrica - Prizren, është punuar duke u bazuar në projektin e ndërtimit, gjendjen aktuale të objektit, karakteristikat e lokacionit, gjendjen ekzistuese të mjedisit rreth lokacionit ku është ndërtuar stacioni i karburanteve si dhe dokumenteve teknik ekzistues.

Detyra e përgatitjes së këtij raporti të VNM-s për stacionin e karburanteve kryesisht ka për qëllim identifikimin e burimeve të ndotjes, vlerësimin e ndikimit të tyre në mjedis si dhe propozimin e veprimeve për parandalimin, përkatësisht zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis gjer në kufijtë e lejuar.

Të gjitha konstatimet dhe rekomandimet për mbrojtjen e mjedisit që dalin nga ky raport, duhet të merren për bazë, gjatë fazës së aktiviteteve të punës të stacionit të karburanteve dhe pas përfundimit të aktivitetit të punës së stacionit te karburanteve ”Hib Petrol ” sh.p.k. ne vendin e quajtur B. Kidrica, rruga Lekë Matrënga - Prizren.

Kompania këtë stacion te karburanetë e ka te emruar si ”Hib Petrol” sh.p.k. Prizren (3), dhe kështu do i referohemi në vijim.

## 2. BAZA LIGJORE PËR HARTIMIN E RAPORTIT

Raporti i VNM-së është hartuar në bazë të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/l-181 (2023), i cili përcakton te gjitha procedurat për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim të VNM -së. Ky Ligji për Vlerësimin e Ndikimit ne Mjedis ka për qëllim për të siguruar mundësimin e një vlerësimi të përgjithshëm me ndërthurje të ndikimeve mjedisore të projekteve apo veprimtarive që do të realizohen me qëllim qe të parandalojnë dhe të zvogëlojnë apo mënjanojnë efektet negative në mjedis në kohen e duhur.

Analiza përfshin identifikimin e masave mbrojtëse për mjedisin me rastin e ndonjë aksidenti në mjedis gjatë funksionimit kontinuel të stacionit të karburanteve edhe at :

- Identifikimin e burimit që rrezikon mjedisin
- Vlerësimin e ndikimit në mjedis
- Propozimin e masave themelore për minimizimin apo zvogëlimin e ndikimeve negative gjer në kufijtë e lejuar.

## 2.1 Rregullativa ligjore për hartimin e VNM-së

### a) Dokumentacioni normativ

Me rastin e hartimit të Raportit të VNM -së për stacionin e karburanteve ”Hib Petrol” sh.p.k. Prizren (3), janë marrë për bazë ligjet më të rëndësishme të aplikuara si më poshtë:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji nr. 08/l-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (2023)
- Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja Nr. 08/L-025 (2022)
- Ligji për Mbeturinat Nr.08/L-071 (2022) për ndryshim dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-060 (2012) për mbeturina
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji për planifikim hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110
- Ligji për tokën bujqësore Nr. 02/L- 26
- Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr. 03/L-233
- Ligji Nr. 03/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugë Nr. 2003/11
- Ligji për kimikate Nr. 04/L-197

- Ligji për mbrojtjen nga zhurma Nr. 02/L-102
- Ligji për mbrojtjen nga zjarri Nr. 04/L-012
- Ligjit Nr. 03/L-138, për ndryshim dhe plotësim të Ligjit Nr. 02/L-89 për tregti me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë
- Udhëzimi administrativ (MMPHI) Nr.02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese te shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujor
- Udhëzim administrativ (QRK) Nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes
- Udhëzim administrativ (QRK) – NR. 03/2021 për menaxhimin mbeturinave të rrezikshme
- Udhëzim administrativ (QRK)- NR. 08/2017 për menaxhimin e deponive të mbetur.
- Udhëzimi administrativ Nr.13/2013 për katalogun shtetëror të mbeturinave
- Udhëzimi administrativ MMPH, Nr.10/2015 për trajtimin e mbeturinave nga produktet medicinale.
- Udhëzimi administrativ Nr. 07/2012 për cilësinë e karburanteve të lëngëta të naftës
- Udhëzimi administrativ Nr.05/13. për menaxhimin e vajrave të përdorura dhe mbeturine.

**b) Dokumentacioni teknik**

- Projekti i ndërtimit të stacionit e karburanteve ”Hib Petrol” sh.p.k. Prizren (3) me objektet përcjellëse, gjendja reale ne terren
- Certifikata e regjistrimit të biznesit
- Certifikata mbi të drejtat e pronës
- Kopja e planit të ngastrës
- Plani i situacionit.
- Pëlqimi i komunal për ushtrimin e veprimtarisë ose njoftimi-informimi sipas PZHK

Duke marrë parasysh faktin se një pjesë e madhe e specifikave mjedisore nuk janë përfshirë në kuadër të rregullativës së sipërshënuar për nevojat e hartimit të këtij raporti është shfrytëzuar edhe rregullativa relevante ndërkombëtare si dhe direktivat përkatëse si që është direktiva e VNM-së (85/337/EEC).

## 2.2. Metodologjia e punës

Metodologjia e punës me të cilat bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis për stacionin e karburanteve me objektet përcjellëse, bëhet në disa faza.

a) Informatat themelore që nënkupton identifikimet si që janë:
- burimet themelore të ndikimeve në mjedis.
- popullata ekzistuese me karakteristikat demografike.
- karakteristikat e dheut, topografia dhe peizazhi në lokacionin ku është ndërtuar stacioni i karburanteve.
- klima e lokacionit me të dhënat meteorologjike,
- kualiteti i ajrit dhe ujit në lokacionin më të gjerë,
- bota bimore dhe shtazore në terrenin e analizuar.

b) Vlerësimi i ndikimeve sipas këtyre kualifikimeve
- madhësia dhe lloji i ndotjes
- karakteristikat dhe dominimi i materialit ndotës
- gjendja e mjedisit në terrenin e analizuar
- vlerësimi i shpërndarjes në hapësirë i materies ndotëse.

c) Analiza e rrezikimit të
- njeriut
- vlerave materiale
- vlerave natyrore.

- d) Përcaktimi i masave mbrojtëse sipas rezultateve të arritura mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis në lokacionin ku është ndërtuar stacioni i karburanteve ”Hib Petrol” Sh.P.K. Prizren (3).

Pjesa më e rëndësishme e analizës së këtij raporti i kushtohet vlerësimit të gjendjes ekzistuese. Hulumtimi karakterizohet me faktin se kemi të bëjmë me vendin që nuk ka të bëjë me ndonjë potencial të shprehur ekologjik. Rezultati i këtyre analizave paraqet një dëshmi mbi gjendjen aktuale të mjedisit në këtë lokacion.

# 3. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT

Karakteristikat themelore të gjendjes ekzistuese të lokacionit janë bazë themelore për hartimin e Raportit të VNM -së. Hulumtimi dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese është bërë duke i shfrytëzuar hulumtimet studimore të bëra në këtë teren.

Për të u definuar gjendja ekzistuese në mënyrë të kënaqshme dhe për të u krijuar një bazë reale për hulumtim të ndikimeve të mundshme, në kuadër të gjendjes ekzistuese janë prezantuar edhe të dhënat relevante që kanë të bëjnë me të dhënat ekzistuese morfologjike, gjeologjike, hidrologjike, hidrografike dhe meteorologjike.

## 3.1. Potencialet ekzistuese

Njëri nga elementet kyçë te hulumtimi i gjendjes ekzistuese të mjedisit është hulumtimi i potencialit ekzistues, e që konsiston ne analizën e mirëfilltë të tërësisë hapësinore ne zonën më të gjer të stacionit te karburanteve "Hib Petrol" sh.p.k. Prizren (3), me qëllim që ne bazë të pasojave të njohura të vlerësohen mundësit e rrezikut ekologjik dhe ne bazë te tyre të rekomandohen masat për zvogëlimin ose edhe eliminimin e tyre.

Karakteristikat e potencialit ekologjik përbëhen nga kombinimi i ndikimeve të ndërsjella të faktorëve natyror siç janë toka, uji, ajri, relievi, flora dhe fauna.

Çdonjëra nga potencialet ekologjike ne këtë mënyrë posedon funksione të caktuara, që ne esencë kanë rëndësi të dorës së parë analizën e problematikës së tërësishme të mbrojtjes së mjedisit.

Ndikimi i ndërsjellë i faktorëve të veçanet si dhe ndikimi i tyre ne formimin e potencialit ekologjik dhe i funksioneve të tyre themelore me interes për analizën ne fjalë, së bashku me kompleksin e marrëdhënieve të mundshme.

Është e qartë që faktorët natyror formojnë disa potenciale natyrore karakteristikat funksionale të cilave duhen marrë parasysh gjatë valorizimit të ndikimit në mjedis të stacionit të karburanteve të ndërtuar ne hapësirën e lartcekur.

## 3.2. Pozita gjeografike e lokacionit

”Hib Petrol” SH.P.K. gjendet në njësitë kadastrale Nr. **P-71813068-11561-3**, vendi i quajtur B. Kidrica, Rr. Lekë Matrënga, në zonën kadastrale Prizren, Komuna e Prizrenit. Pamjet e lokacionit të ”Hib Petrol” sh.p.k. Prizren (3), figura 1 dhe 2.




*Figura 1. Stacioni i karburanteve ”Hib Petrol” SH.P.K.– Prizren (3)*




*Figura 2. Situacioni i ”Hib Petrol” sh.p.k. Prizren (3)*

Lokacioni ku është i ndërtuar stacioni i karburanteve, është zonë e urbane dhe shume aktivitete me shume biznese, për shkak të pozitës gjeografike që ndodhet, figura 1 dhe 2.

Në afërsi të drejtpërdrejt të ngastrës ku është i ndërtuar stacioni i karburanteve objektet përreth ndodhen si në vijim:

- <u>Në **veri** të stacionit te karburanteve</u> ”Hib Petrol” sh.p.k. Prizren (3) lokacioni (parcela) kufizohet me rrugën Lekë Matrënga, ku ka qasje stacioni i karburanteve dhe përtej saj objekte afariste dhe banimore, në radhitje njëra pas tjetrës, një gjendje tipike ne vendbanime periferike te qytetit, si në figurën 1&2, përkatësisht figurën 3 në vijim.




*Figura 3. Pamja në veri të stacionit te karburanteve ”Hib Petrol” sh.p.k. Prizren (3)*

Në **lindje** të stacionit të karburanteve ”Hib Petrol” sh.p.k. Prizren (3), lokacioni (parcela) kufizohet me objekte afariste, dhe përtej saj gjendet hapësirë e lire qe dominohet nga gjelbërimi. Zona është zone e kombinuar afariste/ banimore, si në figurën 2, përkatësisht figurën 4 në vijim.




*Figura 4. Pamjet në lindje të stacionit te karburanteve ”Hib Petrol” sh.p.k. Prizren (3)*

Në **jug** të stacionit të karburanteve ”Hib Petrol” sh.p.k. Prizren (3), lokacioni (parcela) kufizohet me parkun (gjelbërim) qe i takon Spitalit te përgjithshëm Prizren, si në situacionin - figurën 2, përkatësisht figurën 5 në vijim.




*Figura 5. Pamja në jug të ”Hib Petrol” sh.p.k. Prizren (3}*

Në **perëndim** të stacionit te karburanteve ”Hib Petrol” sh.p.k. Prizren (3), shtrihet rruga qe Lekë Matrënga, përkatësisht rrethi qe bashkon dhe dy rruge tjera vijuese dhe përtej tyre, parku i qytetit dhe hapësirat qe i takojnë Universitetit Ukshin Hoti. Përtej saj gjendet objekt tjera banimore dhe afarist në radhitje njëra pas tjetrës, si në situacionin - figurën 2, përkatësisht figurën 6 në vijim.



*Figura 6. Pamja në perëndim të ”Hib Petrol”sh.p.k. Prizren (3)*

Në bazë të gjitha analizave është sajuar mundësia për vlerësimin global të gjendjes ekzistuese të mjedisit jetësor si dhe ndikimeve të mundshme negative gjatë punës së depos së karburanteve.

## 3.3. Popullata dhe vendbanimet

Njërën nga veçoritë qenësore të hapësirës së analizuar, në kuptim të përcaktimit të ndikimeve të mundshme në mjedis, e paraqet popullata dhe demografia e saj. Këto fakte kuptimin e plotë të tyre e kanë në hulumtimin e hollësishëm të ndikimeve të mundshme negative në banorët që jetojnë në hapësirën e analizuar.

Komuna e Prizrenit përfshin një sipërfaqe prej 640 km2 (5.94 % te territorit të Kosovës) posedon 76 vendbanime me 220.776 banorë nga të cilët në Prizren jetojnë rreth 110.000 banorë. Komuna e Prizrenit në bazë të sasisë së ujit është një ndër vendet më të pasura në Republikën e Kosovës.

Kjo pozitë krijon të gjitha parakushtet për zhvillimin e kulturave bujqësore, blegtorisë, industrisë ushqimore dhe të turizmit. Përmes anës së Prizrenit kalon rruga më e shkurtër që bashkon pjesën qendrore të gadishullit Ballkanik me detin Adriatik. Kjo rrugë, për arsye politike nga e kaluara sot nuk ka rëndësi aq të madhe, është një rast i mire që me valorizimin e saj te shfrytëzohen të gjitha përparësitë e saj, duke mare parasysh që në të kaluarën ka pas ndikim primar në zhvillimin e Prizrenit.

Kushtet hidrologjike dhe kushtet natyrore të komunës së Prizrenit ndikojnë në zhvillimin e bujqësisë dhe për zhvillimin e aktiviteteve turistike dhe rekreative.

E gjithë kjo ka ndikim në strukturën ekonomike të Prizrenit, prandaj bujqësia dhe turizmi merret si pjesë madhore e aktiviteteve ekonomike në komunën e Prizrenit. Në afërsi të lokacionit te këtij projekti, në mënyrë të drejtpërdrejtë nuk atakohen.

## 3.4. Lidhjet e komunikacionit

Lokacioni ka lidhje mjaft te mira komunikacioni afër rrugës, e cila lidhet me pjesën tjetër te Prizren dhe periferisë se saj dhe me të gjithë rrjetin rrugor të Kosovës. Furnizimi me energji elektrike dhe infrastrukture tjetër qe bëhet përmes rrjetit elektrik ekzistues, infrastruktura e ujësjellësit, te nevojshme për këtë projekt është i mire.

## 3.5. Kushtet klimatike

Klima e kësaj treve sipas pozitës së saj gjeografike dhe sipas hulumtimeve meteorologjike siç janë: reshjet dhe temperaturat mesatare mujore dhe vjetore është klimë kontinentale. Në viset e ultë për shkak të ndikimit të klimës mesdhetare dhe verave shumë të nxehta të korrurat janë nder të parat në Evropën juglindore prandaj ekzistojnë përparësitë e pakrahasueshme për kulturat bujqësore: hardhia e rrushit, pemët dhe perimet.

Në viset malore, dominon klima e alpeve, për ç'arsye deri në Qershor nëpër gropa mbeten sasitë e bores me ç'rast në mes të verës mund të zbardhohen majet e maleve. Sa i përket temperaturave dhe reshjeve, Pranvera dhe Vjeshta karakterizohen përafërsisht me klimë të njëjtë.

Temperatura mesatare sillet prej 11,5˚C gjer në 12,5˚C e si mesatare e këtyre merret temperatura prej 12,0˚C. Temperaturat më të larta janë në muajin qershor 35,6˚C, ndërsa në korrik 32,4˚C dhe në gusht 31,1˚C. Temperaturat më të ulta janë në muajin dhjetor, janar dhe shkurt. Temperaturat maksimale mesatare vjetore janë 22,5˚C, ndërsa temperaturat mesatare minimale sillen prej -0.5˚C.

Të reshurat janë të formës riguese ose me karakter lokal. Regjimi i reshjeve ne komunën e Prizrenit ka karakterin e klimës aride.

Shuma e përgjithshme e reshjeve sillet nga 670 mm deri ne 820 mm. Vlera mesatare vjetore e lagështirës relative është 66.8%. Muaji më i thatë është gushti 66.2%, kurse më me lagështi janë nëntori dhe dhjetor 84.2 %.

## 3.6. Erërat

Në lokacionin ku shtrihet ky projekt, për shkak të konfiguracionit e posaçërisht pozitës gjeografike më së shumti janë të përfaqësuara erërat veriore dhe ato jugore nga liqeni i Fierzës. Me intensitet më të madh të shpejtësisë paraqiten erërat veriore, veri perëndimore si dhe erërat perëndimore, kurse ato jugore janë me intensitet më të vogël. Në komunën e Prizrenit erërat më të shpeshta janë ato veriore me 226‰ dhe më të rrallat janë ato jug – perëndimore me 27‰, kurse shpejtësia mesatare më e madhe e erës është 3.2 m/sek.

## 3.7. Hidrogjeologjia

Karakteristikat hidrogjeologjike të lokacionit janë të thjeshta - morfologjia, ndërtimi gjeologjik, tektonika janë faktorët dominantë të cilët definojnë lëvizjen e ujërave sipërfaqësor dhe ato nën tokësor. Në afërsi të lokacionit ku shtrihet ky projekt, burime natyrore të ujit (ne zonën përreth) ka mjaft. Në distanc qindra metra kalon dhe rrjedha të lumit Drini i Bardhë, ujërat sipërfaqësore të cilat krijohen gjatë të reshurave atmosferike, drenohen në kanalet natyrale (përroskat) dhe pastaj drenohen në lumin e Drini i Bardhë.

Në aspektin hidrologjik ujërat sipërfaqësorë të komunës së Prizrenit karakterizohen me ujera të bollshme sipërfaqësore të cilat drenohen në lumin Drini i Bardhë. Nëpër këtë regjion kalon lumi më i madh në Kosovë, Drini i Bardhë, i cili përshkon pjesën perëndimore të Kosovës, respektivisht Rrafshin e Dukagjinit për 122 km në drejtimin veri-jug, buron nga një gurrë në Bjeshkën e Rusolisë, sipër fshatit Katundi i Ri në vendin e ashtuquajtur Radavc (afër qytezës së Burimit). Ujërat e lumit të Drinit të Bardhë nevojitën për ujitjen e tokave që shtrihen afër shtratit të tij.

## 3.8. Natyra dhe biodiversiteti

Në bazë të të dhënave zyrtare të Institutit për mbrojtjen e Natyrës, nuk ekzistojnë të dhëna se në këtë teren kemi të bëjmë me ndonjë hapësirë të mbrojtur me ligj, në drejtim të biodiversitetit dhe natyrës në përgjithësi, por as që është ndonjë zonë që është potencial të futet nën mbrojtje.

## 3.9. Bimësia dhe vegjetacioni

Në bazë të shqyrtimeve vizuale në rrethin të zonës ku realizohet projekti kemi hasur në bimësi që karakterizohet kryesisht nga bimët e ultë barishtore dhe drunjet (me tpik ne parqet tona) dhe ne zona perreth – viset rurale hasen kulturat bujqësore si misër, grurë, tërshërë, tërfoje etj, kurse ne lokacionin më të gjer  bimësi drusore si qarri, bungu,  kaça, murrizi,  mana,   manaferra, kurse ngastra  ku shtrihet ky projekt  tani zona është tipike urbane.

## 3.10. Fauna

Bazuar në florën ekzistuese dhe kushtet klimatike të rajonit, e duke marrë për bazë edhe të dhënat nga vendasit, në zonë perretj (periferi te qytetit dhe zona rurale) përpos kafshëve dhe shpezëve shtëpiake  jetojnë gjitarët, zvarranikët, brejtësit, insektet e ndryshme, lepuri i egër, dhelpra, ujku, derri i egër etj. Prej brejtësve jetojnë-mijtë, prej zvarranikëve-gjarpri i zakonshëm,  breshkat e tokës zhapini i gjelbër etj, ndërsa prej shpezëve janë karakteristike, bilbilat, thëllënëzat e fushës, sorrat, shqiponja, etj.

## 3.11. Peizazhi

Karakteristikat e peizazhit të tërësisë  së analizuar hapësinore paraqesin njërin nga elementet për të perceptuar marrëdhëniet e tërësishme në relacionin projektin  dhe mjedisin.

Me këtë rast gjithsesi duhet marrë parasysh se bëhet fjalë për një kategori psikologjike afektive  e cila manifestohet përmes veprimit të tërësishëm të rrethinës në shikuesin, ku medoemos janë të pranishme implikimet  kulturologjike, sociologjike dhe subjektive .

Efektet vizuale (peizazhet) janë kriteriume me rëndësi në ruajtjen e mjedisit dhe nëse nuk zgjidhen drejt konsiderohen si degradim i mjedisit. Ky projekt nuk ka ndonjë ndikim negativ në prishjen e peizazhit në lokacionin e analizuar, sepse në këtë  lokacion janë të ndërtuara objekte tjera  si dhe objektet për këtë projekt janë objekte ekzistuese dhe syri i njeriut është mësuar me këtë gjendje të objekteve industriale.

## 3.12 Ajri

Edhe pse ne rrethin të këtij lokacioni  deri tani nuk janë bërë matje mbi shkallën e ndotjes së ajrit, ujit, tokës dhe zhurmës në mënyrë që të bëhet një vlerësim sa më preciz i gjendjes mjedisore për lokacionin ku shtrihet ky projekt. Nga vetë pozita e lokacionit si dhe objekteve ekzistuese të më

hershme ne rrethin dhe objektet tjeraqë janë ndërtuar dhe  duke u ndërtuar ne ketë lokacion ndikojnë në ndotjen e ajrit, frekuenca e madhe e automjeteve në rrugën  ndikojnë në ndotjen e ajrit, poashtu mund të konkludojm se ndotja e ajrit  në këtë regjion është evidente deri ne një mase qe është tpike për këto zonat urbane.

## 3.13. Uji

Ndotja e ujit  shkaktohet nga ndikimet urbane, pluhuri dhe gazrat, qarkullimi i automjeteve dhe aktivutet tjera punuese. Ndotja e ujit pjesërisht shkaktohet edhe nga lëshimi i ujërave të zeza nga komuniteti të pa trajtuara si dhe hedhja e  tyre. Ndotja e ujerave nga ky projekte do te jete si ndotje shtese, andaj do te vlerësohen ndikimet dhe do te propozohen masa për mbrojtjen e ujerave, ne kapitujt ne vijim.

## 3.14. Aspektet kulturore - historike

Qyteti i Prizrenit është një ndër qendrat më të vjetra të Kosovës, andaj ekonomia e këtij qyteti është zhvilluar edhe me herët dhe vijon te zhvillohet ne këto dekadat e fundit, me nje hov me te madhe. Një ndër faktorët më të rëndësishëm nga e kaluara historike për formimin e qytetit dhe të zhvillimit ekonomik të tije, është padyshim ndërtimi i infrastrukturës rrugore dhe infrastrukturave tjera përcjellëse. Kjo shumë e rëndësishme për transportimin e udhëtarëve dhe të mallrave, që njëkohësisht ndikoi shumë në ndryshimin e fizionomisë së vendbanimit transformuar ne lagje të qytetit.

Aspektet kulturore historike, monumentale ne Prizren janë nder me te shquarat ne republikën e Kosovës, si Lidhja e Prizrenit dhe shume ngjarje dhe fakte te tjera kulturore historike te evidentuara ne këto treva. Andaj çdo aktivitet banesor / afarist ne këto pjese duhet seriozisht te analizoj dhe te faktohet se nuk do te cenon këto vlera. Andaj me kujdes është vlerësuar se ky projekt përkatësisht zona e ngushte ku shtrihet ky projekt nuk paraqet ndo ne zone te ngushte te këtyre aspekteve dhe se nga ky aktivitet nuk cenohen aspektet kulturore historike te Prizrenit dhe rrethinës.

## 4. PËRSHKRIMI TEKNIK I STACIONIT TE KARBURANTEVE

**Objekti i stacionit te karburanteve "Hib Petrol" në Prizren P+0**

- Ideja
- Konceptimi i objektit në situacion
- Funksioni i objektit
- Konstruksioni
- Përdorimi i materialeve në eksterier dhe enterier
- Ndriçimi
- Zgjidhja arkitektonike e objektit

**Ideja -** Objekti i Stacionit te karburanteve "Hib Petrol" në Prizren P+0, ngastra kadastrale Nr. P-71813068-11561-3 me sipërfaqe prej S=1410 $m^2$, në Prizren.

**Konceptimi i objektit ne situacion** - ngastrat në fjalë kufizohensi ne vijim:
Në anën veriore kufizohet me rrugën kryesore, ku qasja bëhet përmes rreth rrotullimit; në anën jugore kufizohet me parcelën me numër 11561-4; në pjesën perëndimore kufizohet me rrugë, por nuk ka casje direkte në të; si dhe në pjesën lindore është e lidhur me parcelën tjetër fqinje, me të cilën e ndan gjelbërimi dhe rrethoja.
Objekti është me etazhitet P+0 dhe ka strehën e cila mbron nga reshjet atmosferike shërbimin me karburant që është me etazhitet P.
Pompa funksionon si pompë njëdrejtimëshe ka një hyrje dhe një dalje qendrore, ku pjesa e furnizimit ka hyrje dhe dalje të veçantë nga pjesa lindore e objektit, në të cilën pjesë janë edhe 6 parkingje. Kurse nga pjesa perëndimore, është hyrja e veçantë për në terasë. I tërë oborri ështe trajtuar me infrastrukturë, kanalizim atmosferik, kanalizim fekal, rrjetin e ujesjellesit, sistemin e ujitjes si dhe sistemin e ndriqimit të oborrit.

**Funksioni i objektit** - Ky si objekt ka një funksion të përzier ku kemi hapësira administrative në shërbim të konsumatorëve, hapësirat e shitjes, hapësirat gastronomike, hapësirat teknike dhe përcjellëse.

**Përdhesja:** Përdhesja është konceptuar me hyrje qendrore për në hapësirën e marketit dhe në hapësirën e restaurantit, një hyrje për në terasë e cila lidhet me hapësirën e restaurantit, një hyrje ekonomike dhe një hyrje për shërbime teknike. Në përdhesë janë vendosur katër grupacionet kryesore funksionale. Ne anën lindore janë vendosur funksionet përcjellëse duke filluar nga hyrja ekonomike, kthina teknike, garderobat dhe sanitarjet per punëtorë, depot dhe frigodhomat për deponimin e ushqimeve, si dhe kuzhina kryesore e restoranit. Kthina teknike është e destinuar për vendosjen e kaldajës dhe pajisjeve të ngrohjes dhe ftohjes. Në pjesën veriore është e vendosur hyrja kryesore dhe një zyre. Nga hyrja kryesore kalon në market, dhe duke vazhduar në pjesën perëndimore ku gjendet restoranti, i cili lidhet me terasën e objektit, e cila është e vendosur në pjesën veriore të objektit.

**Konstruksioni i objektit** - është sistem mix: sistem skeletor dhe konstruksion metalik. Pjesa afariste është menduar të punohet nga betoni i armuar ndërsa mbulesa tek hapësira e derivateve është menduar të punohet nga konstruksioni metalik. Moduli i konstruksionit është i zgjedhur në bazë të hapësirave funksionale dhe zgjidhjes arkitektonike. Kulmi mbi përdhese është projektuar si kulm i rrafshet me shtresa të parapara.
Streha mbi hapësirën ku janë vendosur pompat për shërbimin e derivateve është e projektuar si mbulesë me konstruksion metalik e mbështetur në katër pika mbështetje kontruktive me nga dy shtylla qift për secilën pikë mbështetje. Themelet e strehës janë themele të veçuara dhe pllaka mbi themele është pllakë beton arme e finalizuar me ferobeton.

**Përdorimi i materialeve në enterier dhe në eksterier**

**Muret e jashtme -** janë me trashësi 25 cm me blloka të siporeksit të trajtuara nga ana e brendshme me llaq dhe gletim kurse nga ana e jashtme me veshje me fasadë te ventiluar me termoizolim lesh guri t= 8 cm. Ana ballore është e punuar me fasadë kontinuale nga alumini me xham tero E-low me efiqience termike shumë të mirë me koeficient termik 1.1 $W/m^2$ K. këto mure në pjesën hyrëse te objektit në përdhese shërbejnë që të kemi një lidhje më të mirë vizuale nga jashtë me pjesën e brendshme të objektit.

**Muret e brendshme** - janë nga blloqet e siporeksit të cilat do të suvatohen me llaq dhe do gletohen deri në finale. Muret të cilat i ndajnë nyjat sanitare, depotë dhe kuzhinën janë mure nga blloqet e siporeksit te suvatuara me llaq me baze çimentoje dhe të veshura me pllaka të qeramikës.

**Dyshemetë** - në te gjitha hapësirat, sanitaret, garderobat, kuzhina është menduar të vendosen pllakat e keramikës teknike kurse ne pjesët tjera ku janë marketi, restorantit dhe administrate janë me pllaka porcelan.

**Ndriqimi -** në hapësirat funksionale kryesisht është ndriçim natyral por ka edhe ndriçimi artificial të dimensionuar në mënyrë adekuate për funksion të objektit.

**Zgjidhja arkitektonike** e objektit - forma e objektit është kryesisht si rezultat i funksionit të brendshëm dhe idesë së arkitekturës të cilën e kemi menduar. Është një arkitekturë e kombinuar nga arkitektura organike për nga forma, dhe në momente për nga përdorimi i materialeve, si dhe në anën tjetër shihen disa lëvizje të arkitekturës moderne. E gjitha e projektuar duke menduar qëndrueshmërinë urbane.

**Objekti** - përmban hapësirën për administratë, hapësirën për shitjen, hapësirën për restorant etj, si ne vijim:

- Marketi
- Restoranti
- Terasa
- Banjo
- Zyrat
- Depo, gardëroba, dhe hapësira tjera përcjellëse,
- Platoja e pompës (streha)
- Hapësirat e parkingjeve,
- Pompat për toçitje te nafte dhe benzine - 4 pompa (nafte dhe benzine) me 8 gypa për toçitje te naftës dhe 8 gypa për toçitje te benzinës,
- Separatori për trajtim te ujqërve
- Oazat gjelbëruese,
- Shtyllat e reklamës etj.

Dyshemeja është e  asfaltuar, me një pamje standarde - bashkëkohore. Ne objekt janë te ndërtuara pikat e sanitari së dhe hidranti. Pikat e sanitari së  janë të punuara  krejt sipas rregulloreve dhe standardeve bashkëkohore.

Mbulesa e pikës (streha) për shitjen e karburanteve është e punuar nga konstruksioni i kapriates  metalike, trau kryesor është i punuar  nga shufrat metalike.

Mbi kapriate janë te vendosura brinaket te profilit  (metalike) dhe mbi te llamarina e plastifikuar. Për arsye estetike streha ne anët e jashtme te mbulesës është punuar me një panel nga llamarina e plastifikuar.

Ana e poshtme e mbulesës është punuar material metalike, ne bazë të specifikacionit të përshkruar ne projektin kryesor për ndërtimin e stacionit të karburanteve.

## 4.1. Platoja e kompleksit

Platoja e stacionit të karburanteve është rregulluar  ashtu që  pjerrtësia të jetë e përshtatshme për përcjelljen e ujërave sipërfaqësore, të tërë pjesës  për rreth  objektit administrativ  dhe për rreth objektit për shitjen e karburanteve është e  betonuar.

Organizimi për funksionimin e këtij stacioni të karburanteve  është  i destinuar për funksionimin e qarkullimit ne rrugën ndërlidhëse, hyrja dhe dalja e automjeteve  në kompleksin e stacionit të karburanteve  bëhet pa pengesa sepse hapësira për hyrje ne stacion të karburanteve  dhe dalje është e mjaftueshme dhe dukshmëria është e mirë.

## 4.2. Rezervarët e lëndëve djegëse të lëngëta - naftë dhe benzinë

Ne stacionit të karburanteve  janë vendosur gjithsej 4 rezervuar për nafte dhe  benzinë, figurat ne vijim (6, 7, 8 dhe 9).

*Rezervuar  për  benzinës me kapacitet:  R1= 20 267 litra  dhe R2= 10 064 litra*

*Rezervuar  për  naftës   me kapacitet: R3= 21 172 litra  dhe R4= 38 997 litra*




*Figura 7. Rezervuarët e naftës dhe benzinës*

Rezervarët janë cilindrik të ndërtuar prej çelikut me mure të dyfishtë sipas standardeve të caktuara për rezervarët për deponimin e lëndëve djegëse të lëngtë (nafte dhe benzine) dhe janë të vendosur nën tokë në pozitë horizontale, ne hapësirën e betonuar dhe të rrethuar me mure betoni, të mbështetur në mbajtëset (shalat) nga betoni dhe te shtrënguara me nga shirita metalik anti korroziv për secilën mbajtëse, me qëllim të përforcimit për të mos lëviz nga presionet e ndryshme nëntokësore.

Mbrojtja nga korrozioni bëhet për mes sistemit të katodës dhe me ngjyrë konform standardeve. Mbushja dhe zbrazja e rezervarëve bëhet nëpër mes të sistemit të gypave special të cilët janë të vendosur në kanal prej betoni për mbrojtjen e tyre nga dëmtimet eventuale.

Gjithashtu në hapësirat e stacionit të karburanteve, është i vendosur edhe gjeneratori i rrymës elektrike, për rastet e nevojshme te kompanisë.




*Figura 8. Gjeneratori i energjisë elektrike*

## 4.3. Karakteristikat e procesit ne stacionin e karburanteve

Procesi teknologjik në stacionin e karburanteve do të përfshin këto operacione të veprimit që janë të ndërlidhura në mes veti.

- sistemi për zbrazje
- sistemi për deponimin e karburanteve
- sistemi për dhënien (toçitjen ) e karburanteve
- Sistemi për zbrazje të karburanteve të lëngët bëhet nga autocisternat me ramje të lirë (apo me anë të pompës) përmes sistemit të gypave prej gome, të cilët përmes një kyçje speciale lidhen me gypin në rezervuar.

Matja e sasisë së deponuar në rezervuar do të matet drejtpërdrejt nga instrumentet matëse të vendosur ne autocisternë ose përmes levës së bazhdaruar dhe tabelave të veçanta për çdo rezervuar. Sistemi i gypave dhe instrumenteve matëse kontrollohen para zbrazjes, në mënyrë që të eliminohen dukuritë e situatave aksidentale.

Sistemi për deponim të karburanteve përbëhet nga dy rezervar për depozitimin e naftës, dy rezervuara te benzinës . Kapaciteti i këtyre rezervuarve është përshkruar ne piken 4.2.

## 4.4. Komponentët hyrëse në procesin teknologjik

Komponentët hyrëse gjatë aktiviteteve që zhvillohen në stacionin e karburanteve janë:

- Karburantet djegëse te lëngëta (naftë dhe benzinë).
- Energjia elektrike dhe uji

Karburantet djegëse te lëngëta benzina dhe nafta shërbejnë për furnizimin e automjeteve, dhe per nevoja industriale. Sasia e përgjithshme e karburanteve ne stacionin e karburanteve (nafte dhe benzine) është dhënë ne piken 4.2.

Energjia elektrike shërben për ndriçim dhe funksionim të pajisjeve si dhe për nxehje. Furnizimi me energji elektrike do të bëhet nga rrjeti shpërndarës i energjisë elektrike.

Uji shfrytëzohet për qëllime sanitare, për larjen e platosë së stacionit të karburanteve dhe për furnizim të pajisjeve kundër zjarrit. Nevojat e ujit për sanitari varet nga numri i punëtorëve p.sh për një punëtor nevojiten rreth 25 litra ujë/dite.

Furnizimi me ujë në kompleksin e stacionit të karburanteve i cili shfrytëzohet për qëllime sanitare, ujë i cili shfrytëzohet për qëllime për larje të platosë si dhe ujitjen e sipërfaqeve të gjelbëruara, bëhet nga sistemi i ujësjellësit të qytetit.

## 4.5. Komponentët dalëse në procesin teknologjik

Komponentët dalëse gjatë aktiviteteve që zhvillohen në stacionin e karburanteve janë :

- Karburantet djegëse te lëngëta (naftë dhe benzinë),
- Avujt i hidrokarbureve dhe gazrat shkarkuese nga automjetet,
- Ujërat e ndotura, mbeturinat e ngurta, zhurma etj.

## 4.6. Alternativat e projektit

Janë analizuar alternativat tjera për lokacione te mundshme, por marre parasysh lokacionin aktual te stacionit të karburantit "Hib Petrol" sh.p.k. Prizren (3), ky lokacion është vlerësuar me përparësi. Përparësitë e këtij lokacioni janë, qasja ne rrugën kyqe te kësaj pjese te Prizrenit, qasja e lehet dhe zona e frekuentuar nga shume makina ne lëvizje, zona përgjatë rrugës është biznesore, dhe me vendbanimeve përtej rrugës (ne brendi te lagjes) si ne përshkrimin me larta-pika 3.2. pozita gjeografike e lokacionit dhe objektet. Alternativat ne aspektin e sigurisë, po asht ne këtë lokacion vlerësohen me përparësi te dukshme. Alternativat e këtij lokacioni ne aspektin mjedisore, janë te qëndrueshme, sepse kemi te

bëjmë me zone te kombinuar banim ore / afariste me një frekuence te larte te lëvizjes se automjeteve - kërkesë kjo kryesore për këtë lloj biznesi dhe nevoja te konsumatorëve te karburanteve.

Po ashtu është shqyrtuar edhe alternativat e tipi te ndërtimit dhe është zgjedhur ky projekt, i cili plotëson standardet e sigurisë teknike dhe ndikimeve minimale ne mjedis. Gjithashtu, alternative e qëndrueshme e këtij projekti është edhe aspekti ekonomik, i zhvillimit te biznesit, ne harmoni me mjedisin dhe sigurinë – pra zhvillimin e qëndrueshëm.

## 5. VLERËSIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS

Analiza e vlerësimit të gjendjes ekzistuese të mjedisit si dhe vlerësimi i ndikimeve të mundshme të cilat janë si pasoj e proceseve (veprimeve) që kryhen ne stacionin e karburanteve tregojnë se deri te kvantifikimi i të dhënave mund të vihet sipas një analize gjithëpërfshirëse.

Të gjitha ndikimet e mundshme nuk janë të vlerave të njëjta që të bëhet edhe kavantifikimi i tyre. Gjatë punës kontinuele të stacionit të karburanteve vjen deri te rritja e emisionit të materieve ndotëse nga puna e automjeteve, avullimi i karburantit benzinë, derdhjet dhe avullimi i karburanteve të lëngët, krijohet zhurmë nga motorët e automjeteve dhe funksionimi i automatëve për dhënie të karburanteve.

Në mënyrë indirekte mund të vjen edhe te deri te ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe sipërfaqeve të dheut afër stacionit të karburanteve.

Entitetet e cenueshme që potencialisht rrezikohen janë të punësuarit në stacion dhe shfrytëzuesit e shërbimeve - konsumatorët.

### 5.1. Ndotja e tokës

Toka si element themelor natyror është një sistem i përbërë ekologjik i cili nga veprimet e ndryshme mund të vjen deri te degradimi i vlerave themelore karakteristike të saja.

Në fazën e shfrytëzimit të stacionit të karburanteve ndotja e dheut është si pasojë e sedimentimit të ndotjeve që sjellën përmes ujërave sipërfaqësore që vijnë nga sipërfaqja e platosë së stacionit të karburanteve dhe nga fundërrimet e komponentëve ndotëse nga ajri.

Kjo ndotje njihet si ndotje sistematike e dheut gjatë funksionimit kontinuel të stacionit të karburanteve pastaj kemi edhe ndotjen aksidentale të dheut e cila vjen si pasoj e avarive të mëdha apo të vogla të pajisjeve.

Këto ndotje të dheut evitohen vetëm me largimin e dheut të kontaminuar dhe transportimin e tij në vendet e caktuara aty ku nuk rrezikojnë mjedisin.

Nga këto të dhëna vërehet se ndotja e tokës afër stacionit të karburanteve varet para se gjithash nga rrjedhja e ujërave të ndotura nga sipërfaqja e platosë së stacionit të karburanteve, konfiguracioni i terrenit dhe nga sedimentimi i ndotjeve prej ajrit në rrethin e stacionit të karburanteve.

## 5.2. Ndotja e ujit

Rreziku më potencial për ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore si dhe ndotja e dheut është nëse vjen deri te shpërthimet e rezervarëve me karburant të vendosur në tokë. Mundësia e derdhjes së derivateve gjatë mbushjes së rezervarëve dhe gjatë toçitjes së derivateve. Pastaj gjatë funksionimit kontinuel të stacionit të karburanteve në sipërfaqet shërbyese për komunikacion vjen deri te sedimentimi i materieve ndotëse që është si rezultat i fundërrimit nga gazrat e djegura motorike, i fshirjes së gomave të automjetit, i rrjedhjes së derivateve dhe vajrave nga automjetet e amortizuara , i fundërrimeve nga atmosfera. Vlerat më të larta të ndotjes së ujërave nga sipërfaqet shërbyese të stacionit të karburanteve pritet të jenë gjatë zezonave të dimrit kur kemi hedhjen e kripës nëpër magjistrale. Koncentrimet e ndotësve të sedimentuar në platon e stacionit të karburanteve drejtpërdrejt varet nga zgjatja e periodave të thata dhe pa shi dhe nga dendësia e qarkullimit të automjeteve. Koncentrimi i grimcave të suspenduara është proporcional me sasinë e ujërave nga shpëlarja apo nga të reshurat atmosferike ku koncentracionet më të mëdha janë në 5- 10 minutat e para të shpëlarjes së sipërfaqes së pllatosë nga personeli apo nga të reshurat atmosferike.

## 5.3 Ndotja e ajrit

Gjatë funksionimit kontinuel të stacionit të karburanteve nga qarkullimet e automjeteve vjen deri te rritja e ndotjes së ajrit nga emisioni i gazrave nga automjetet dhe nga avullimi i karburanteve . Gazrat nga djegiet motorike përmbajnë një numër të madh të komponentëve

ndotëse me koncentrime të ndryshme por më të shprehur dhe më me ndikim në ndotje të ajrit janë: CO, NOx, HxCy, $SO_2$ dhe Pb. Ndikimi i tyre në shkallën e ndotjes varet para se gjithash nga kushtet klimatike –meteorologjike dhe dendësisë së qarkullimit të komunikacionit në lokacionin ku është ndërtuar stacioni i karburanteve.

## 5.4. Zhurma

Në domenin e mbrojtjes së mjedisit zhurma paraqet një faktor me rëndësi hapësinore e cila ka ndikim të madh në dëmtimin e të dëgjuarit, në sistemin nervor, në hipertension, në koncentrim te njeriut në punë etj. Lokacioni i stacionit të karburanteve me objektet përcjellëse është i ekspozuar zhurmës së krijuar nga qarkullimi i automjeteve, autocisternave dhe nga funksionimi i pompave dhe kompresorëve për zbrazjen dhe shpërndarjen e karburanteve dhe në mungesë të energjisë elektrike kyçja e shpeshtë e agregatit për energji elektrike. Sipas gjendjes faktike të kompleksit stacionit të karburanteve në lokacionin e analizuar mundë të konstatojmë se niveli zhurmës i shprehur në dB do të jetë nën vlerën e lejuar prej 60 dB .

## 5.5. Ndikimet në florë dhe faunë

Sipas analizave të bëra deri tani në lidhje me ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës mundë të vjen deri te ndikimet në florë dhe faunë. Mirëpo sipas gjendjes faktike në teren respektivisht në lokacionin e caktuar nuk kemi zhdukje të vegjetacionit pos nga sipërfaqet nën objekte dhe në platonë stacionit të karburanteve kjo do të thotë se kemi të bëjmë me koncentrim të vogël të polutantëve.

E njëjta do të vlente edhe për faunën që do të thotë se nuk pritet të ketë ndikime negative, se fauna edhe ma herët nuk ka ekzistuar ne këtë lokacion sepse stacioni i karburanteve është ndërtuar në lokacionin që kanë ekzistuar vendbanime.

## 5.6. Rreziqet e mundshme ne mjedis, shëndetin e njeriut nga fatkeqësitë ose katastrofat

Në rast fatkeqësisë ose katastrofave, në aspektin e mbrojtjes së mjedisit gjatë manipulimit me derivate të naftës në stacionin e karburanteve është derdhja e derivateve të naftës deri në at sasi që rrezikon mjedisin, prandaj është e nevojshme që të bëhet sanimi i ndotjes sipas

metodave adekuate adekuate ne parandalimin e këtyre rasteve dhe metodave përkatëse për sanimin dhe rehabilitimin e pasojave, nëse ndodhe diçka e tille.

Rrezikimi i mjedisit në stacion e karburanteve në rastet fatkeqësive ose katastrofave mjedisore – është me e mundur te vejnë nga dëmtimi eventual i rezervuarve, nga ndonjë fatkeqësi e pa parashikuar, derdhja e tyre ne toke, ndotja e ujerave sipërfaqësore dhe infiltrimi ne ujera nëntokësore si dhe avullimi i tyre ne ajër.

Masat përgatitore dhe masat për eliminimin e pasojave, analiza e rrezikshmërisë bëhet në tri faza: identifikimi i rrezikut, analiza e pasojave dhe vlerësimi i rrezikut, me qellim te parandalimit te këtyre fatkeqësive evntuale.

## 5.7 Ndikimet e mundshme në trashëgiminë kulturore

Si pas hulumtimit te materialeve përkatëse dhe nga informatat e siguruara ne teren, ne lokacionin e ngushte, ku gjendet stacioni i karburanteve nuk kemi monumente te trashëgimisë kulturore, historike e natyrore te cilat eventualisht do te ndikoheshin apo rrezikoheshin nga ushtrimi i veprimtarisë se stacionit te karburanteve.

Ne lokacionin me te largët përreth stacionit te karburanteve aktivitetet e këtij stacioni te karburanteve nuk kanë ndikime mjedisore dhe rreziqe ekcesiale në hapësirë.

# 6. VLERËSIMI I NDIKIMIT TË MJEDISIT NGA AKSIDENTET E MUNDSHME

Me që kemi të bëmë me stacionin e karburanteve, ku do të kemi deponimin dhe distribuimin e karburanteve të lëngët dhe të gaztë nga edhe buron rrezikimi i mjedisit gjatë rasteve aksidentale. Në rastet e jo zakonshme, gjatë derdhjes jo të kontrolluara të karburanteve të lëngët mundë të vjen deri te aksidentet kimike, intensiteti aksidental i të cilëve mundë të jetë i shkallëve të ndryshme.

Nga manipulimet e ndryshme vepruese me derivatet e naftës në stacionin e karburanteve mundë të vjen deri te rrjedhja apo derdhja e sasive të karburanteve ku nga avullimi i tyre sjell deri te ndotja e ajrit në hapësirën e stacionit dhe hapësirën për rreth tij. Në aspektin teorik aksidentet e një shkalle më të lartë në stacionin e karburanteve mundë ndodhin në rezervuarët me karburante të vendosur në tokë e sidomos gjatë derdhjes (rrjedhjet) si dhe nga auto cisternat.

Të gjitha situatat aksidentale gjatë deponimit dhe distribuimit me derivate të lëngëta mundë të i kategorizojmë në katër grupe:

- Eksplodimi i avullit të karburanteve që janë në gjendje vlimi
- Eksplodimi i gazrave të reve të pakufizuara
- Eksplodimet e kufizuara
- Zjarri

Aksidentin e parë duhet përjashtuar nga analiza sepse për të ardhur deri te ky aksident karburanti në rezervuar duhet të jetë mbi temperaturën e vlimit.

Aksidenti i dytë mundë të shkaktohet gjatë manipulimit me benzinë në stacionin e karburanteve ku mund të vien deri te përzierja e avullit të karburanteve me ajrin dhe të krijojnë një përzierje potenciale e cila gjatë koncentrimeve të caktuara dhe energjisë së mjaftuar për aktivizim mundë të shkaktojë detonacion eksplodues me pasoja të mëdha.

Mundësia e një aksidenti të tillë është shumë e vogël kur kemi parasysh lokacionin e objektit, sasinë e derivateve, dendësinë e automjeteve të cilat furnizohen me derivate, shpejtësinë e avullimit të karburanteve etj.

Në shkallën e detonacionit të një reje nga përziera e avullit të benzinës dhe ajrit, mjaft ndikon edhe numri i oktanëve të benzinës - benzina prej 86 apo 98 oktan në vete përmban tetraetil plumbi që është si mjet antidetonues, pastaj me qëllim të ngritjes së numrit të oktanëve benzinës i shtohen edhe hidrokarbure aromatike benzol ($C_6H_5OH$), toluol ($C_6H_5CH_3$) dhe nëse kjo shtesë është mbi 7% atëherë praktikisht është e pamundur të vie deri te një detonacion i reve të përzierjes së avullit të benzinës me ajër.

